



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 4867 Prot

Shkodër, më 12/03/2020

URDHËR

Nr. 238 datë 12.03.2020

"Për caktimin e ditëve pushim për administratën dhe shërbimeve publike dhe të institucioneve në varësi, në kuadër të masave për mbrojtjen nga përhapja e COVID – 19"

Në kuadër të masave për mbrojtjen nga përhapja e COVID – 19 (Coronavirus), në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i procedurës administrative i Republikës së Shqipërisë", VKM nr. 208 , date 10.3.2020 "Për caktimin e datave 10 deri 23 mars 2020 ditë pushimi për prindin kujdestar të fëmijëve të mitur", si dhe vendimeve të qeverisë të marra sot me datë 12.03.2020,

Urdhëroj :

1. Duke filluar nga dita e sotme datë 12.03.2020 deri me datë 17.03.2020, administrata vendore nuk do të jetë në punë.
2. Duke filluar nga dita e sotme datë 12.03.2020 deri me datë 17.03.2020, kërkohet qëndrimi i detyruar në shtëpi.
3. Ngarkohen punonjësit e administratës dhe shërbimeve publike të Bashkisë Shkodër, punonjësit Njësive Administrative dhe Institucioneve të Varësisë së Bashkisë Shkodër.
4. Sipas planit të punës të drejtuesve dhe në bashkëpunim dhe kordinim me eprorët direkt, duhet të vijojnë punën administrative, të realizueshme në kushte shtëpie.
5. Për zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhri ngarkohen ngarkohen punonjësit e administratës dhe shërbimeve publike të Bashkisë Shkodër, punonjësit Njësive Administrative dhe Institucioneve të Varësisë së Bashkisë Shkodër.

6. Punonjësit e shërbimit të MZSH –së dhe policisë bashkiake janë në gadishmëri, në shërbim sipas planit të punës dhe urhërvetë drejtuesve.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

